



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Vlora A. Ahmeti" B.I. të datës 28.03.2023 kundër B54 formulari standard për korigjimin

prokurimit me titull "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 31 221, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Vlora A. Ahmeti" B.I. të datës 28.03.2023 kundër B54 formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 22.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 31 221.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Vlora A. Ahmeti" B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Vlora A. Ahmeti" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 28.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër B54 formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 22.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 31 221.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim:

- *“Pasiqe pas ndryshimit dhe njoftimit përmes formularit standard për korigjim të gabimeve të datës 22.03.2023 nuk keni lene afat për sqarim në u detyruam që të bëjme kerkese për rishqyrtim”.*
- *“Po ashtu të kapaciteti teknik profesional keni kerkuar që OE duhet të jap një deklaratë se i përmbahet specifikimeve teknike të percaktuara në Aneksin 1. Në si OE në momentin e nënshkrimit të Deklaratës se i përmbahemi specifikimeve teknike të percaktuara në Anex 1 duhet doemos që paisje adekuate që liron avull të nxehtë në temperatura min 120 0 C ta posedojme apo ta marrim në shfrytëzim me marreveshje me qira”.*
- *“Po ashtu arsytimi i operatorit kerkues dhe i juaji se ULV në specifikacionin e tyre nuk ceket ky parameter është i gabuar pasiqe kemi të bëjme me dy pajisje të ndryshme. Paisje adekuate që liron avull të nxehtë në temperatura min 120 0 C nuk perdor fare insekticid por me temperature të lartë bene dezinfektimin që në rastin konkret të kerkuar në specifikimet teknike është të bëje dezinfektimin e shtreterve neper institucione parashkollore. Ndersa ULV janë pajisje që mbushen me ujë dhe insekticid dhe dezinfektues që lirojnë avull të ftohtë që gjatë lirim të avullit lirojnë insekticidet dhe dezinfektuesit”.*

Duke u referuar të pretendimi i tij, parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim ka kërkuar nga autoriteti kontraktues si në vijim:

- *“Kerkojme nga ana e juaj të jepni vendimin se*
  - 1. Në si OE duhet të ofrojme deshmi për posedimin e Pajisjes adekuate me avull të nxehtë në temperature minimumi 120 C si dhe të deshmojme kopjet e certifikatave të analizave për të gjitha preparatet sipas specifikimeve teknike. Apo*
  - 2. Të nënshkruhet deklarata dhe se bashku me deklaratë të deshmohen edhe dokumentet e kerkuara në specifikimet teknike Apo*
  - 3. Nëse nuk aprovohet njëra nga keto me lartë të ndryshoni specifikimet teknike”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”).

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Dosja e tenderit e datës 02.03.2023;
- Formulari B54 për korigjimin e njoftimit për kontratë i datës 22.03.2023;
- Vendimi i datës 22.03.2023 mbi kërkesën për rishqyrtim të OE “Vlera” Sh.P.K.

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 05.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP sipas elaborimeve në vijim.

Fillimisht duhet cekur se në dosjen e tenderit të datës 02.03.2023 për këtë aktivitet të prokurimit, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në seksionin 9.1 dhe 9.2. lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale në rubrikën nr. 3 është kërkuar ndër të tjera edhe "*Pajisje adekuate për dezinfektim që liron avull të nxehtë me temperaturë min. 120C - minimumi 1 copë*". Ndaj kësaj kërkesë në dosjen e tenderit me datë 21.03.2023 operatori ekonomik "Vlera" Sh.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim duke kërkuar që lidhur me këtë pajisje të largohet kufizimi i temperaturës së avullit minimumi 120 gradë celsius me arsyetimin se temperatura e pajisjes mund të rregullohet manualisht duke u bazuar në programimin e shtypjes sipas logjikës sa më shumë bar aq më e lartë temperatura dhe anasjelltas. Zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 22.03.2023 ka marrë vendim përmes të cilit ka miratuar këtë kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin se kufizimi i temperaturës së avullit prej 120 gradë celsius në pajisjen përkatëse do të mund të kufizonte konkurrencën e lirë brenda tenderuese. Rrjedhimisht bazuar në nenin 28 të LPP lidhur me nenin 19 të RRPP është kërkuar që pajisja e kërkuar të vazhdoj të mbetet si kërkesë e dosjes së tenderit mirëpo të largohet kufizimi i temperaturës së avullit prej 120 gradë celsius si kriter kufizues dhe potencialisht diskriminues apo favorizues. Mbi bazën e këtij vendimi autoriteti kontraktues me datë 22.03.2023 ka publikuar B54 formularin standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara përmes të cilit ka njoftuar se pajisja në fjalë do të vazhdon të mbetet si kërkesë në dosjen e tenderit mirëpo do të largohet kufizimi i temperaturës së avullit prej 120 gradë celsius.

Sa i përket kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit, duhet cekur se parashtruesi më tepër ka paraqitur paqartësitë e tij lidhur me efektet juridike të B54 formularit standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 22.03.2023 sesa që ka adresuar një pretendim konkret për shkeljen e ndonjë dispozite ligjore lidhur me procedurën në fjalë të prokurimit publik. Lidhur me pjesën e pretendimit të parashtruesit ku thuhet "*Pasiqe pas ndryshimit dhe njoftimit përmes formularit standard për korigjimin të gabimeve të datës 22.03.2023 nuk keni lene afat për sqarim në u detyruam që të bejme kerkese për rishqyrtim*", është gjetur se parashtruesi ka mundur të parashtroj kërkesë me shkrim për informacione shtesë apo sqarime në përputhje me nenin 24 të RRPP. Sidoqoftë mund të thuhet se më sipër janë ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme lidhur me paqartësitë që ka evidentuar parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim.

Sa i përket pjesës së pretendimit ku thuhet *“Po ashtu te kapaciteti teknik profesional keni kerkuar qe OE duhet te jap nje deklarate se i permbahet specifikimeve teknike te percaktuara ne Aneksin 1. Ne si OE ne momentin e nenshkrimit te Deklarates se i permbahemi specifikimeve teknike te percaktuara ne Anex 1 duhet doemos qe paisje adekuate qe liron avull të nxehtë në temperatura min 120 0 C ta posedojme apo ta marrim ne shfrytezim me marreveshje me qira”*, është gjetur se në rast të kolizionit në mes të thënieve në kërkesat e dosjes së tenderit dhe B54 formularit për korigjimin e dosjes së tenderit, duhet të merren parasysh thëniet në formularin B54. Në këtë mënyrë duhet të bëhet edhe vlerësimi i tenderëve nga komisioni përkatës vlerësues. Prandaj kjo pjesë e pretendimit është mjaft kontraverze dhe lidhur me të janë dhënë shpjegimet më sipër në këtë vendim.

Sa i përket pjesës së pretendimit ku thuhet *“Po ashtu arsytimi i operatorit kerkues dhe i juaji se ULV ne specifikacionin e tyre nuk ceket ky parameter eshte i gabuar pasi qe kemi te bejme me dy pajisje te ndryshme”* është gjetur se ky konstatim është i saktë nga parashtruesi. Mirëpo ky fakt nuk duhet të ishte as kontestues pasi që përmes formularit B54 asnjëherë nuk është larguar pajisja në fjalë si kërkesë e dosjes së tenderit. Ndryshimi që është bërë ka të bëjë vetëm me temperaturën e avullit që lëshon kjo pajisje. Pra është larguar kufizimi prej 120 grad celsius dhe sipas formularit B54 tanimë kërkohet vetëm *“Pajisje adekuate për dezinfektim që liron avull të nxehtë”*. Në këtë mënyrë është eliminuar çdo dyshim se kërkesat e dosjes së tenderit janë diskriminuese apo favorizuese. Në fakt ky ndryshim do duhej të interpretoj si mundësi për stimulimin e konkurrencës ndërmjet tenderuesve sepse është larguar një kufizim i caktuar lidhur me një pajisje të caktuar, dhe jo anasjelltas.

Sa i përket kërkesës së parashtruesit që ose të kërkohet nga tenderuesit që të dëshmohet pajisje përkatëse me avull të nxehtë minimumi 120 gradë celsiues ose të ndryshohen specifikimet teknike, është gjetur se kjo kërkesë e parashtruesit është kundërtënjësore dhe paradoksale për arsye se korigjimet e nevojshme tanimë janë bërë tanimë përmes formularit B54 të datës 22.03.2023. Nga kjo rezulton se parashtruesi në fakt nuk ka kundërshtuar asnjëherë formularin B54 të cilin e ka goditur me këtë ankesë por vetëm ka pasur nevojë për sqarime dhe informacione shtesë lidhur me efektet juridike mbi dosjen e tenderit të këtij formulari. Prandaj këto sqarime janë ofruar në mënyrë të mjaftueshme më sipër në këtë vendim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Rrjedhimisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është gjetur se të gjitha pretendimi i parashtruesit është i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.04.2023

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.